

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6962
E hënë, 7 gusht 2023
Çmimi 0.40

Në gusht pritet të nisin fluturimet në korridorin ajror Kosovë - Shqipëri

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NJOHËSI I PROCESHEVE POLITIKE NË VEND, MILAZIM KRASNIQI, KA FOLUR PËR SITUATËN NË VERI DHE ZGJEDHJET E REJA TË PARALAJMËRUAR NË KATËR KOMUNAT VERIORE

FAQE 4-5

VEPRIM URGJENT DORËHEQJA E KATËR KRYETARËVE NË KOMUNAT VERIORE DHE MBAJTJA E ZGJEDHJEVE




Njohësi i proceseve politike në vend, Milazim Krasniqi, ka thënë se Ruisë i konvenon zgjatja e krizës në veriun e Kosovës. Ai thotë se vendimi absurd për targat dhe disa nga masat që pasuan kanë prodhuar pasoja kundër interesit

tonë shtetëror. "Krizja e tashme mund të rritet edhe më shumë në vjeshtë nëse qeveria Kurti nuk e kupton që kjo krizë po i duhet Ruisë. Rusia synon të formojë në veriun e Kosovës një lloj Abhazie, Osetie ose Donbasi, për ta mbajtur

peng shtetin e Kosovës dhe për ta rritur influencën ruse në rajon", ka theksuar Krasniqi, duke theksuar se ndër veprimet urgjente duhet të jetë dorëheqja urgjente e katër kryetarëve në komunat veriore dhe mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve

PRESIDENTI I MALIT TË ZI: NJOHJA E PAVARËSISË SË KOSOVËS, ÇËSHTJE E PËRFUNDUAR

FAQE 2



S'KA ZGJIDHJE PËR SIGURIMIN SHITESË KUFITAR

FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



ISH-ZËVENDËSPRESIDENTI PENCE MUND TË DËSHMOJË NË GJYQ KUNDËR TRUMPIT

F. 2

QEVERIA E KOSOVËS KËRKON NGA BE-JA HEQJEN E MASAVE NDËSHKUESE

F. 5

BIE NUMRI I APLIKIMEVE NË UP, REKTORATI: NDËR ARSYET EDHE LARGIMI I TË RINJVE

F. 5

EKONOMI

Trendi i Borxhit Shtetëror



MURATI: KOSOVA BËHET SHTETI ME NIVELIN MË TË ULËT TË BORXHIT SHETËTOR NË EVROPË

F. 3

FRIKA NGA INVESTIMET RIT KURSIMIT E QYTETARËVE NË BANKA

F. 7

SPORT



KRASNIQI PAS TRIUMFIT NË PRISHTINË: FALEMINDERIT TË GJITHËVE

F. 10

Slovakia i lejon nëntë qytetarë të vet t'i bashkohen ushtrisë ukrainase

BRATISLAVË, 6 GUSHT - Presidentja e Sllovakisë, Zuzana Caputova, u ka dhënë leje nëntë qytetarëve sllovakë për të shërbyer në ushtrinë ukrainase e cila është duke luftuar kundër pushtimit rus.

Mediet sllovaqe raportuan më 5 gusht se Caputova i vlerësoi 35 kërkesa të qytetarëve për të luftuar përkrah ushtrisë ukrainase dhe i pranoi nëntë prej tyre. Arsyet e pranimit apo refuzimit

të kërkesave nuk janë dhënë. Sipas ligjit në fuqi në Sllovaki, qytetarët sllovakë kanë të drejtë t'i bashkohen ushtrisë së një vendi të huaj vetëm me lejen e presidentit të vendit. Pa një leje të tillë, sllovakët

përballen me ndjekje penale. Në fillim të këtij muaji Republika e Çekisë njoftoi se u ka dhënë leje të ngjashme 146 qytetarëve të vet qëkur nisi pushtimi rus i Ukrainës në shkurt 2022.



Pakistan, 22 të vdekur, 50 të lënduar pasi treni doli nga binarët



ISLAMABAD, 6 GUSHT - Të paktën 22 persona kanë vdekur dhe mbi 50 të tjerë janë lënduar si pasojë e daljes së një treni nga shinat në jug të Pakistanit të dielën, njoftuan zyrtarët pakistanezë.

Younis Chandio, zyrtar i lartë policor, tha për mediet lokale më 6 gusht se operacionet e shpëtimit kanë nisur t'i nxjerrin njerëzit nga vagonët. Ai tha se 10 vagonë të trenit dolën nga binarët.

Ndërkohë, ministri i

Hekurudhës i Pakistanit, Khawaja Saad Rafique, tha se "ky është një aksident shumë i madh. Ekipet e shpëtimit kanë mbërritur në vendngjarje".

Treni doli nga binarët afër stacionit hekurudhor Sahara në qytetin Nawabshah në jug të provincës Sindh.

Pamjet e publikuara në rrjetet sociale i shfaqin dhjetëra njerëz në vendngjarje, disa prej të cilëve duke i thyer dritaret për t'i ndihmuar udhëtarët të dalin nga vagonët e rrokullisur.

Aksidentet dhe daljet e trenit nga binarët ndodhin shpesh në sistemin e vjetruar hekurudhor në Pakistan.

Në qershor 2021 dy trena u përplasën mes vete afër Daharkit në Sindh, duke i vrarë të paktën 65 njerëz dhe duke i lënduar rreth 150 të tjerë.

Të paktën 75 udhëtarë u dogjën në një zjarr që e kishte kapluar trenin Tezgam në tetor 2019, derisa nga përplasja e dy trenave në Ghotkit vdiqën më shumë se 100 njerëz më 2005.

Ish-zëvendëspresidenti Pence mund të dëshmojë në gjyq kundër Trumpit

WASHINGTON, 6 GUSHT - Ish-zëvendëspresidenti i Shteteve të Bashkuara nga Partia Republikane, Mike Pence, nuk e ka hedhur poshtë mundësinë për të qenë dëshmitar i prokurorisë, nëse ish-shëf i vet Donald Trump përfundon në gjyq nën akuzat për orkestrimin e një konspiracioni kriminal për ta shfuqizuar disfatën e tij në zgjedhjet presidenciale më 2020.

I pyetur nga CBS nëse ai do të bëhej dëshmitar kundër Trumpit, nëse rasti shkon në gjykim, Pence tha se nuk ka "plane" për të dëshmuar, por nuk e hodhi poshtë mundësinë për ta bërë këtë. "Por, njerëzit mund të kenë besim se ne do t'i bindemi ligjit, ne do t'i përgjigjemi thirrjes së ligjit, nëse vjen ajo, dhe ne thjesht do ta themi të vërtetën", tha Pence, i cili po garon kundër Trumpit në garën për kandidatin e republikanëve për president.

Pence u bë figurë qendrore në



aktakuzën e fundit kriminale që u ngrit ndaj Trumpit më 1 gusht nga Departamenti i Drejtësisë, e cila e ngarkon ish-presidentin e Shteteve të Bashkuara (ShBA) me akuzat se ka tentuar të mbetet në pushtet jashtëligjshëm, pasi i humbi zgjedhjet presidenciale kundër demokratit Joe Biden më 2020.

Trumpi u deklarua i pafajshëm për

të gjitha akuzat më 3 gusht.

Para dhe gjatë certifikimit të fitores së Bidenit në Kongres më 6 janar 2021, Pence i mbikëqyri procedurat në rolin e tij ceremonial si president i Senatit të ShBA-së. Ai u përball me trysni të madhe nga Trumpi për ta shfuqizuar rezultatin e zgjedhjeve, por nuk pranoi.

Disa nga përkrahësit e Trumpit, të



cilët shkaktuan trazira në Kapitolin e ShBA-së, brohoritën "vareni Mike Pences!" Ajo trysni e vazhdueshme dhe "shënimet e njëkohshme" që Pence i kishte marrë gjatë procedurave dhe trazirave të 6 janarit 2021 citohen shpesh në aktakuzën e javës së kaluar kundër Trumpit.

Në një pikë, aktakuza i referohet një telefonate të 1 janarit 2021, gjatë së

cilës Trumpi e qortoi Pencen pse nuk kishte marrë pjesë në planin për ta shfuqizuar rezultatin e zgjedhjeve. "Ju jeni shumë i sinqertë", i kishte thënë Trumpi, Pences.

Dëshmia e mundshme e Pences dhe shënimet e tij mund të bëhen pjesë kyçe për rastin e prokurorisë kundër Trumpit.

Për herë të parë në fushatën fillestare, Trumpi e sulmoi Pencen të shtunën. Ai e mohoi se e kishte vlerësuar atë si "tejet të sinqertë", por e quajti atë tani "Mike Pence i vogël". Fushata presidenciale e Pences ka dështuar të marrë hov deri tani, madje rrezikon të mos ia dalë të jetë as në debatin e parë republikan presidencial në fund të këtij muaji për shkak të mungesës së donatorëve.

Derisa ai ka mbetur shumë mbrapa, Trumpi është duke i prirë bindshëm garës së republikanëve, pasi ka shijuar rritje në sondazhe sa herë që është ngritur aktakuzë ndaj tij.

Maldivë, gjykata ia ndalon garimin në zgjedhje ish-presidentit Yameen

MALE, 6 GUSHT - Gjykata Supreme e Maldives konfirmoi të dielën se ish-presidenti Abdulla Yameen Abdul Gayoom, i cili është i burgosur, e ka të ndaluar të garojë në zgjedhjet presidenciale në shtator.

Ky vendim është një tjetër goditje për Partinë Progresive

të Maldives (PPM), e cila e shpalli Yameenin kandidat të partisë për zgjedhjet e reja, para se ai të dënohej me burg në dhjetor për korrupsion dhe shpëlarje parash derisa ishte president.

Yameen, 64 vjeç, është duke e kryer një dënim me 11 vjet burgim.

Gjykata Supreme e mbajti në fuqi vendimin e Komisionit të Pavarur Zgjedhor për t'ia ndaluar Yameenit garimin për president më 9 shtator.

PPM-ja nuk e kishte nominuar asnjë kandidat tjetër për president, duke shpresuar se Yameeni do të ishte në gjendje të garonte pas ankesës në

Gjykatën Supreme.

Afati i fundit për dorëzimin e kandidatëve për president ishte 3 gushti, por u zgjat për katër ditë, deri të hënën e 7 gushtit.

Presidenti Ibrahim Mohamed Solih, i cili e mposhti Yameenin në zgjedhjet e shtatorit 2018, po garon për t'u rizgjedhur.



Presidenti i Malit të Zi: Njohja e pavarësisë së Kosovës, çështje e përfunduar



PODGORICË, 6 GUSHT - Presidenti i Malit të Zi, Jakov Milatović, ka deklaruar se njohja e pavarësisë së Kosovës, anëtarësimi i vendit në NATO dhe sanksionet kundër Rusisë si pjesë e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së Bashkimit Evropian, janë çështje të përfunduara. Milatović këtë deklaratë e dha për RTV Slovenia.

Ndërkaq në Komitetin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian (KPJPE), ai tha se në vitin 2020 ndodhi "për herë të parë në histori ndryshimi demokratik" i qeverisë në këtë vend.

Procesi i ndryshimit demokratik në Mal të Zi, siç tha ai, u kompletua nga triumfi i tij në zgjedhjet presidenciale. Ai më tutje nënvizoi se "regjimit të kaluar i mungoi vullneti politik" për ndryshime në procesin e pranimit në Bashkim Evropian (BE).

Ai tha se, pas këtyre ndryshimeve, Mali i Zi tani e ka një gjeneratë të re politikanësh të cilët janë "vërtet evropianë", dhe jo "evropianë të cilët bënë kompromise të rreme". "Mbase 10, 12, apo pesë vjet më parë kishte stabilitet, stabilitet politik, dhe institucione, por ishte diçka si 'fshati polemakin'", tha Milatović në KPJPE, duke e përdorur këtë term për ta përshkruar mbulimin e realitetit të padëshirueshëm.

"Ato institucione ekzistuan vetëm në letër. Ndryshimet reale po ndodhin tani", theksoi kreu i shtetit malazez.

Milatović beson se pas ndryshimit të qeverisë, Mali i Zi e ka një prokuror të mirëfilltë, i cili merret me procese të rëndësishme në lidhje me korrupsionin dhe krimin e organizuar, kundër njerëzve të cilët "ishin pjesë të krimit dhe korrupsionit". Ai shprehu besimin se në mbledhjen e

radhës, Parlamenti i Malit të Zi do të shfaqë forca demokratike evropiane dhe njoftoi për formimin e qeverisë në javët në vijim.

Duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve të Parlamentit Evropian në lidhje me marrëdhëniet me Beogradin zyrtar, Milatović tha se Serbia është partnere e rëndësishme ekonomike për Malin e Zi.

"Natyrish, është racionale të kesh marrëdhënie normale politike me partnerin tonë më të madh ekonomik", tha Milatović.

Duke iu referuar vizitës në Beograd, ai konfirmoi se kishte biseduar për nevojën e emërimit të një ambasadori, organizimin e takimeve të përbashkëta mes dy qeverive dhe pikëkalime të përbashkëta kufitare.

Sa i përket bashkëpunimit rajonal, Milatović beson se Mali i Zi nuk ka telashe të hapura serioze me vendet fqinje, por e

pranoi se kjo gjendje "është trashëgimi nga regjimi i kaluar".

Presidentit të Malit të Zi iu kërkua të komentojë edhe rreth Ballkanit të Hapur. Ai theksoi se për të prioritet është procesi i Berlinit, dhe rikujtoi se e kishte thënë këtë gjë edhe gjatë inaugurimit si president.

Ballkani i Hapur, thotë Milatović, shërbeu për ta "ringjallur" procesin e Berlinit, i cili në një çast kishte ngecur për shkak të largimit të kancelares gjermane Angela Merkel dhe se, sipas tij, ajo është "gjëja e vetme e mirë që e bëri ai".

Mali i Zi cilësohet si lider në procesin e anëtarësimit në BE. Ky vend ka qenë kandidat që nga viti 2010 dhe më 2012 i hapi bisedimet për anëtarësim me Brukselin.

I hapi të gjithë kapitujt e procesit të anëtarësimit, por i mbylli përkohësisht vetëm tre kapituj. Pavarësisht faktit se vlerësohet si

vendi më i avancuar në bisedimet për anëtarësim, që nga viti 2012 Mali i Zi nuk e ka pasur asnjë konferencë ndërqeveritare (që është brenda kornizës së bisedimeve për anëtarësim) për shkak të përparimit të pamjaftueshëm në procesin e reformave, që është hap shumë i nevojshëm për të shënuar përparim në bisedimet për anëtarësim.

Presidenti i Malit të Zi premtoi rezultate "agresive" në procesin e reformave dhe nguli këmbë se është reale të pritët që vendi i tij të anëtarësohet në BE në vitin 2027 apo 2028. Ai i kërkoi Komisionit Evropian ta shtyjë publikimin e raportit të progresit në mënyrë që Mali i Zi të ketë kohë për të dëshmuar rezultate pozitive.

Raporti për vendet në procesin e integritit në BE publikohet nga Komisioni Evropian çdo vit në tetor.

Murati: Kosova bëhet shteti me nivelin më të ulët të borxhit shtetëror në Evropë

PRISHTINË, 6 GUSHT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se Kosova bëhet shteti me nivelin më të ulët të borxhit shtetëror në Evropë. Ai thotë se kjo ka ndodhur falë disiplinës fiskale e mirëmenaxhimit të parasë publike. "Kemi arritur që ta ndryshojmë trendin e borxhit shtetëror duke e kthyer

sërisht në nivele të parapandemisë. Një konsolidim i tillë është vlerësuar lart dhe nga institucionet ndërkombëtare", ka shkruar Murati në "Facebook".

Ai ka thënë se ky konsolidim së pari e mban nën kontroll koston e kamatave sepse, sipas

Muratit, sa më pak borxh aq më pak pagesë e kamatave. "Së dyti na mundëson kushte më të favorshme financimi për huamarrjet e reja në krahasim me të tjerët, sepse kemi dëshmuar qëndrueshmëri dhe mirëshpenzim të parasë publike", ka thënë ministri Murati.

Trendi i Borxhit Shtetëror





NJOHËSI I PROCESIVE POLITIKE NË VEND, MILAZIM KRASNIQI, KA FOLUR PËR SITUATËN NË VERI DHE ZGJEDHJET E REJA TË PARALAJMËRUAR NË KATËR KOMUNAT VERIORE

Veprim urgjent dorëheqja e katër kryetarëve në komunat veriore dhe mbajtja e zgjedhjeve

Njohësi i proceseve politike në vend, Milazim Krasniqi, ka thënë se Ruisë i konvenon zgjatja e krizës në veriun e Kosovës. Ai thotë se vendimi absurd për targat dhe disa nga masat që pasuan kanë prodhuar pasoja kundër interesit tonë shtetëror. “Kriza e tashme mund të rritet edhe më shumë në vjeshtë nëse qeveria Kurti nuk e kupton që kjo krizë po i duhet Ruisë. Rusia synon të formojë në veriun e Kosovës një lloj Abhazie, Osetie ose Donbasi, për ta mbajtur peng shtetin e Kosovës dhe për ta rritur influencën ruse në rajon”, ka theksuar Krasniqi, duke theksuar se ndër veprimet urgjente duhet të jetë dorëheqja urgjente e katër kryetarëve në komunat veriore dhe mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 GUSHT - Njohësi i proceseve politike në vend, Milazim Krasniqi, ka thënë se Ruisë i konvenon zgjatja e krizës në veriun e Kosovës. Ai ka thënë se me këtë krizë Rusia i bën presion Perëndimit që të mos përfshihet më shumë në ndihmë ndaj Ukrainës. “Me këtë krizë e mban Serbinë të lidhur pas qerres ruse si, gjoja, mbrojtëse e saj nga Perëndimi edhe në KS të OKB-së. Absurd më vete është që qeveria Kurti e ka iniciuar krizën në veri, me atë vendimin për targat e veturave, ndërsa Serbia e shfrytëzoi për ta realizuar skenarin e Ruisë për destabilizimin dhe izolimin e Kosovës”, ka thënë Krasniqi. Ai thotë se vendimi absurd për targat dhe disa nga masat që

pasuan kanë prodhuar pasoja kundër interesit tonë shtetëror. “Kriza e tashme mund të rritet edhe më shumë në vjeshtë nëse qeveria Kurti nuk e kupton që kjo krizë po i duhet Ruisë. Rusia synon të formojë në veriun e Kosovës një lloj Abhazie, Osetie ose Donbasi, për ta mbajtur peng shtetin e Kosovës dhe për ta rritur influencën ruse në rajon. Prandaj qeveria Kurti duhet të ndërmarrë veprime konkrete gjatë këtij muaji, që të shmangët skenari i konfliktit të armatosur që është planifikuar nga Rusia për në vjeshtë”, është shprehur Krasniqi. Ai ka theksuar se ndër veprimet urgjente duhet të jetë dorëheqja urgjente e katër kryetarëve në komunat veriore dhe mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve me pjesëmarrjen e serbëve. “Ata kryetarë janë atje kot dhe nuk përfaqësojnë ndonjë standard

demokracie e as barazie. Është marrëzi që Kosova të mbahet peng i mandatit të tyre të kotë. Ata nuk përfaqësojnë askënd, meqë tre prej tyre nuk guxojnë të dalin në zyra, ndërsa njëri nuk guxon të dalë nga zyra. Pra, mbajtja e zgjedhjeve sa më shpejt mund ta rikthejë procesin e integritetit të serbëve në binarë e me këtë e zvogëlon influencën malinje të Ruisë dhe diktatit fashizoid të Serbisë. Nëse kjo nuk bëhet me vendosmëri, atëherë duhet të kërkohet në pista të tjera përgjegjësia e qeverisë Kurti. Jo vetëm në pistën e përgjegjësive politike”, thotë analisti Krasniqi. Sipas tij, rrezikimi i sigurisë dhe ekzistencës së shtetit dhe rrezikimi i sigurisë së NATO-s, pashmangshëm do të adresohet si përgjegjësi penale. Më 4 gusht kryeministri Albin Kurti ka njoftuar se nga kjo datë

nis zvogëlimi edhe për 25 për qind i pranisë së policisë së Kosovës në tri ndërtesat e komunave në veri të vendit tonë. “Kjo vjen pas vlerësimit të gjendjes së sigurisë nga mbledhja që pardje mbajtën drejtues të Policisë së Kosovës me EULEX-in dhe KFOR-in. Pra, siguria është e mirë, situata është e qetë, dhe mund ta zvogëlojmë ca praninë e policisë sonë. Sundimi i ligjit dhe rendi publik po mirëmbahen gjithnjë e më shumë e më mirë. Janë bërë rreth një muaj e gjysmë që nuk kemi incidente të theksuara e protesta të dhunshme. Falënderojmë policinë dhe qytetarët pa dallim për bashkëpunimin dhe korrektësinë”, ka thënë Kurti, duke treguar më shumë detaje rreth këtij vendimi. “Ashtu qysh kemi thënë para më shumë se dy muajve: 1) nuk do të ketë zvogëlim të përnjëhershëm dhe as të menjëhershëm të pranisë së policisë, por vetëm gradual e proporcional; 2) zvogëlimi vlen për praninë policore në ndërtesat komunale dhe rrethinat e tyre, e jo për veriun e vendit, ku ka ende sfida e punë për sundim të plotë të rendit e ligjit”, thotë ai. Ai ka thënë se po zbatohet me përgjegjësi dhe seriozitet, sinqeritet dhe kujdes, marrëveshjen e Bratisllavës nga

10 korriku 2023 në funksion të kërkesave të BE-së nga 3 qershori 2023 për shpërshkallëzim. “Konstatimi i përbashkët me faktorët ndërkombëtarë për përmirësimin e dukshëm të nivelit të paqes dhe sigurisë në veri dëshmon për shpërshkallëzim të qartë. Njëkohësisht, ne jemi vigjilentë për rrishtimin potencial që mund të vijë nga deklaratat që nxisin urrejtje dhe agresiviteti politik e shtetëror i fqinjit tonë verior”, ka deklaruar Kurti. Për disa javë para ndërtesave janë mbajtur protesta çdo ditë, me kërkesë që kryetarët shqiptarë të tërhiqen, bashkë me pjesëtarët e Policisë së Kosovës të angazhuar në atë zonë. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në zgjedhje të parakohshme për kryetar të komunës mund të shkohet në rast se kryetari aktual jep dorëheqje; në rast se qytetarët kërkojnë shkarkimin e kryetarit të komunës përmes një peticioni të nënshkruar nga 20 për qind e votuesve të komunës përkatëse; si dhe në rast se kryetari i komunës nuk paraqitet në vendin e punës më shumë se një muaj pa arsye. Komuniteti ndërkombëtar i ka kërkuar Kosovës t'i organizojë këto zgjedhje për t'i ulur tensionet.

Qeveria e Kosovës kërkon nga BE-ja heqjen e masave ndëshkuese

PRISHTINË, 6 GUSHT - Qeveria e Kosovës kërkon nga Bashkimi Evropian heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës pas uljes së mëtejshme të pranisë së policisë në dhe rreth objekteve komunale. Sipas ekzekutivit, ata mbeten të përkushtuar për shpërshkallëzim të situatës në veri dhe këtë e dëshmon edhe implementimi i marrëveshjes së Bratisllavës. Mirëpo partitë opozitare dhe analistët politikë thonë se Kosova vazhdon të jetë nën masa për shkak të qasjes së gabuar të kryeministrit Albin Kurti.

Nga zyra e zëvendëskryeministrit, njëherësh kryenegociatorit në dialog, Besnik Bislimi, thonë se masat e Bashkimit Evropian ndaj

Kosovës kanë qenë të padrejta dhe, si të tilla, duhen hequr. "Në vazhdimësi kemi theksuar që masat ndaj Kosovës kanë qenë të padrejta dhe që tashmë duhen hequr. Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë dhe mbetet e përkushtuar për shpërshkallëzim, të cilën e dëshmoi edhe marrëveshja në Bratislavë dhe implementimi në hapat e saj nga ana e Kosovës", thotë Klisman Kadiu, këshilltar i zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi.

Por, kritik ndaj qeverisë është anëtari i kryesisë së LDK-së, Xhafer Tahiri, i cili thotë për KosovaPress se Kosova vazhdon të jetë e ndëshkuar nga Bashkimi Evropian për shkak të politikës së

gabuar të kryeministrit Albin Kurti në dialog dhe në veri.

Në anën tjetër, analisti politik Albinot Maloku shprehet për KosovaPress se përkundër hapave për shpërshkallëzim e situatës në veri, nuk ka asnjë lëvizje në lidhje me largimin e masave ndëshkuese.

Analisti Maloku është skeptik se do të plotësohen kërkesat e qeverisë. Sipas tij, masat do të largohen pas shpalljes së zgjedhjeve të reja dhe shpërshkallëzimit të plotë të situatës në komunat veriore. "Veç ardhja në situatën kur kemi sanksione nga faktori ndërkombëtar, konkretisht Bashkimi Evropian, është një prej treguesve të dështimit të

qeverisë aktuale. Mirëpo, në anën tjetër, pas marrëveshjes së Bratislavës ka pasur hapa të ndërmarrë që, përveç tregues si vullnet i mirë Qeverisë së Kosovës për shpërshkallëzim e situatës në veri, faktori ndërkombëtar gjithmonë na ka kujtuar se i përshëndet hapat, por nuk është i kënaqur. Për pasojë jemi në situatën që nuk kemi ende tërheqje të sanksioneve. Konsideroj se me Bashkimin Evropian nuk mund të shkojmë me kapacitetet", ka deklaruar ai.

Bashkimi Evropian ka vendosur masa ndëshkuese ndaj Kosovës për shkak të mosmarrjes së veprimeve për shtensionimin e situatës në veri. Këto masa kanë

hyrë në fuqi më 28 qershor, derisa përfshijnë pezullimin e programit të fondeve për Kosovën, pezullimin e mbështetjes së vazhdueshme për prokurimin dhe nënshkrimin e kontratave, pezullimin e pjesëmarrjes në ngjarjet e nivelit të lartë, pezullimin e vizitave dypalëshe, si dhe propozimin e dorëzuar nga Kosova për kornizën investuese për Ballkanin Perëndimor që nuk do të procedohet në këtë moment. Bashkimi Evropian ka kërkuar përkushtim më të madh nga pala e Kosovës për zbatimin e kërkesave për shtensionimin e plotë të situatës në veri, ku përfshihet edhe shpallja e zgjedhjeve në veri.



Bie numri i aplikimeve në UP, Rektorati: Ndër arsyet edhe largimi i të rinjve

PRISHTINË, 6 GUSHT - Mbi 6 100 të rinj kanë aplikuar për t'i vazhduar studimet në Universitetin më të madh publik në vend, atë të Prishtinës (UP), për vitin akademik 2023/24. Ky numër është për mbi 1 800 më pak se për vitin akademik aktual 2022/23.

Nga Rektorati i UP-së thonë se numri i ulët i studentëve lidhet me faktin se edhe numri i maturanëve në nivel vendi ka rënë, por nuk e përjashtojnë që ndikim ka edhe largimi i të rinjve. UP do të hapë konkurs plotësues edhe për 2 700 vende të lira në fakultetet e saj.

Nga organizatat studentore të UP-së thonë se mungesa e

vendeve të punës pas diplomimit i ka bërë shumë të rinj që të mendojnë të largohen pa përfunduar as ciklin e studimeve bachelor në Kosovë, ndërsa renditin edhe arsye të tjera. Por, profesoresha e Universitetit të Arteve, Besa Luzha, thotë se nuk është e domosdoshme që të rinjtë të vazhdojnë patjetër studimet. Rektorati i Prishtinës, përmes një përgjigje me shkrim për KosovaPress, konsideron se shkak i numri të ulët të aplikimeve në fakultetet e Universitetit të Prishtinës janë edhe "lëvizjet e brendshme dhe të jashtme të të rinjve në Kosovë".



Në gusht pritet të nisin fluturimet në korridorin ajror Kosovë - Shqipëri

PRISHTINË, 6 GUSHT - Marrëveshja për korridorin ajror ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë ende nuk është duke u zbatuar në tërësi. Ujdia ndërmjet autoriteteve të Kosovës dhe Shqipërisë ishte firmosur në vitin 2020. Por, ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka thënë për KosovaPress se zbatimi i marrëveshjes për hapjen e korridorit ajror Kosovë - Shqipëri pritet të ndodhë gjatë këtij muaji.

Në anën tjetër nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë nuk janë përgjigjur lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në Kosovë kanë thënë se me publikimin e pikave ajrore në AIP të Shqipërisë në korrik të vitit 2023 pritet ndërrimi i attributeve të këtyre pikave nga Eurocontrol, respektivisht nga Network Manager që të bëhen edhe flight plannable së shpejti. Ministri Aliu ka dhënë më shumë detaje rreth korridorit ajror Kosovë - Shqipëri. "Sa i



përket korridoreve me Republikën e Shqipërisë, korridoret janë të përcaktuara, tash kanë dalë edhe në uebfaqe. Ende nuk janë, nuk i di këto shprehjet teknike që i kanë ekspertët ajrorë, por duhet që ato të konfirmohen si të tilla në mënyrë që të bëhen të planifikueshme në fluturimet ndërkombëtare. Në shumicën e fluturimeve ndërkombëtare që bëhen nga Aeroporti i Prishtinës

për në aeroporte të tjera e që është rruga më shkurtër nga ato pikat që janë me Republikën e Shqipërisë realizohen. Në kthim një pjesë e tyre realizohen, një pjesë e tyre nuk realizohen për shkak se shpesh janë të paplanifikuara", ka thënë Aliu. Ministri Aliu ka deklaruar se ka gatishmëri dhe vullnet edhe me zëvendëskryeministren, njëherësh ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë,

Belinda Balluku dhe me autoritetet e Albcontrollit që të gjitha fluturimet të nisin të realizohen nga muaji gusht 2023. "Mendoj se në muajin gusht është koha kur ato do të duhej të dilnin në uebfaqe. Ka ekzistuar një afat prej momentit kur është publikuar në uebfaqe dhe është afati kohor kur duhet të zbatohet dhe mendoj se do ta kemi shpejt. Përndryshe vullneti ekziston, edhe me ministren e

Transportit në Republikën e Shqipërisë, Belinda Balluku, por edhe me autoritetet e Albcontrollit. Pra, gatishmërinë e kanë", ka thënë Aliu.

Nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror në Kosovë në një përgjigje me shkrim për KosovaPress kanë theksuar se: "Letër-marrëveshja për korridorin ajror në mes të Shqipërisë dhe Kosovës është nënshkruar në vitin 2020 dhe nga viti 2021 ka filluar të zbatohet. Këto korridore kanë filluar të shfrytëzohen nga fundi i vitit 2021 në baza taktike. Me publikimin e pikave ajrore në AIP të Shqipërisë në korrik të vitit 2023 pritet ndërrimi i attributeve të këtyre pikave nga Eurocontrol, respektivisht nga NetworkManager që të bëhen edhe flight plannable së shpejti".

Para katër muajsh Kosova dhe Mali i Zi kanë nënshkruar marrëveshjen bilaterale për korridorin ajror që mundëson lejimin e shfrytëzimit të hapësirës ajrore të Malit të Zi nga aeroplanët që fluturojnë nga Aeroporti i Prishtinës.

Dy të arrestuar nën dyshimin për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 6 GUSHT - Policia e Kosovës i ka arrestuar dy persona të dyshuar për krime lufte në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 në dy operacione të ndara në dy ditët e fundit.

I dyshuari me inicialet Zh. Z. u arrestua të shtunën në mesditë në fshatin Lubozhadë në Istog, njoftoi Policia e Kosovës në një komunikatë për medie më 5 gusht. Ai dyshohet për veprën penale "krime lufte kundër popullatës civile" të kryer gjatë vitit 1998-1999 në komunën e Istogut. "Gjatë kohës së luftës në Kosovë në vitin 1998-1999 ka pasur pozitën e komandantit të nënstacionit policor në fshatin Rakosh të komunës së Istogut. I njëjti është sjell në zyrat e DHKL-së ku pritet të intervistohet në cilësi të të dyshuarit në prani të

avokatit mbrojtës", thuhet në njoftimin e policisë. Arrestimi i 69-vjeçarit të shtunën vjen vetëm një ditë pasi hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Luftës e prangosën një të dyshuar tjetër të premtën në pikën kufitare në Merdar. "Këto hetime kanë qenë të përqendruara rreth zbulimit të autorëve të krimeve të kryera në periudhën 1998-1999 në rajonin e komunës së Istogut. Në vazhdim të angazhimeve hetimore është arritur të mblidhen dëshmi dhe prova për krimet dhe kryesit e këtyre veprave penale", thuhej në njoftimin e policisë të premtën. Policia tha se hetuesit policorë kanë pranuar dhe përpunuar informata të shumta operative në drejtim të identifikimit,



vendndodhjes dhe lokalizimit të të dyshuarit, aktivitetit dhe lëvizjeve të tij, në dhe jashtë territorit të Kosovës, para se ta arrestonin të dyshuarin me inicialet M. P. në pikën kufitare me Serbinë. "Nga bashkërendimi i aktiviteteve

është bërë e mundur të identifikohet një i dyshuar për krime lufte, i cili në kohën e luftës 1998-1999 ishte kryeshef i milicisë në Istog. I dyshuari M. P., me aktvendim nga prokurori i njëjtë, është dërguar në mbajtje deri në 48 orë".

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka reaguar ndaj arrestimit të M. P., duke e kundërshtuar vendimin e autoriteteve kosovare. Ai e zbuloi identitetin e të arrestuarit të parë, duke e emëruar si Momir Pantiq, dhe tha se "dije ai duhej t'i merrte dokumentet në lidhje me pronën e tij në Istog, por në vend të kësaj u arrestua dhe u dërgua në Prishtinë".

Pantiq besohet se pas luftës është zhvendosur nga Istogu dhe ka jetuar në Mladenovac të Serbisë. "Prishtina i arreston serbët nën pretekstin për krime lufte dhe i paragjykon ata, duke u dërguar atyre mesazh të qartë se as nuk janë të mirëseardhur e as të dëshiruar në vatrat e veta shekullore", tha Petković.

Presidentja Osmani: Djegia e shtëpisë së Joziqit, akt i papranueshëm

PRISHTINË, 6 GUSHT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka quajtur "akt të papranueshëm" djegien e shtëpisë së Svetislav Joziqit në një fshat të Istogut pas një vizite më 5 gusht.

Osmani e vizitoi shtëpinë e serbit të kthyer të Kosovës, e cila u dogj nga persona të panjohur më 10 korrik, duke e cilësuar atë "vepër kundër Republikës sonë".

"Istogu ka qenë gjithmonë një

shembull shndritës i gjithpërfshirjes që e ka mbërthyer forcën e diversitetit. Djegia e shtëpisë së familjes Joziqi është vepër e papranueshme. Derisa ne po ua rindërtojmë shtëpinë atyre, jemi të përkushtuar të sigurohemi se ata do të ndihen të sigurt", shkroi presidentja Osmani në rrjetin social X, i njohur dikur si "Twitter".


Më 7 korrik të këtij viti Joziq

mori çelësat e një shtëpie të sapondërtuar në fshatin e tij të lindjes, Veriq, në territorin e komunës së Istogut. Vetëm tri ditë më vonë ai u njoftua se autorë të panjohur ia kishin vënë zjarrin.

Svetislav Joziq është i pari serb i kthyer në fshatin Veriq të komunës së Istogut.

Lajmi për djegien e gjeti atë në Jagodinë, një qytet në Serbi ku ai jeton i zhvendosur për më shumë se dy dekada.





S'ka zgjidhje për sigurimin shtesë kufitar

PRISHTINË, 6 GUSHT - Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm në Evropë që nuk bën pjesë në Këshillin e Byrove Evropiane - duke mbetur ende jashtë Sistemit të Kartanit të Gjellbër.

Autoritetet në Kosovë nuk duan të komentojnë nëse po ndërmarrin hapa në mënyrë që vendi të bëhet pjesë e mekanizmit mbrojtës për viktimat e aksidenteve në trafikun ndërkufitar të shkaktuar nga automjetet e huaja. Si certifikatë ndërkombëtare e sigurimit të automjeteve, Kartoni i Gjellbër njihet nga autoritetet e 47 vendeve. Ky lloj sigurimi mbulon dëmet personale ose materiale që mund të shkaktohen në rast të aksidentit në territorin e një shteti ku vlen Kartoni i Gjellbër dhe merret kur sigurohet automjeti. Si i tillë, ai vlen në të gjitha shtetet që e kanë në përdorim.

Vitin e kaluar autoritetet në Kosovë synuan përfshirjen në Sistemin e Kartanit të Gjellbër përmes një shteti tjetër, por deri më tani asgjë nuk është finalizuar në këtë drejtim.

Statuti i Këshillit të Byrove Evropiane, përveç të tjerash, thekson se, për të pranuar një shtet, ai duhet të jetë anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Kosova nuk është pjesë e OKB-së.

Mospërfshirja, e kushtueshme në Kartonin e Gjellbër

Derisa Kosova nuk është pjesë e Kartanit të Gjellbër, sigurimi i automjeteve që lëshohet në Kosovë nuk vlen për vendet e tjera. Automjetet me regjistrim të huaj, të cilat hyjnë në Kosovë, duhet të paguajnë sigurim shtesë pavarësisht nëse kanë ose jo Kartonin e Gjellbër.

Një gjë e tillë më së shumti prek qytetarët e Kosovës që jetojnë dhe punojnë në vende të ndryshme të



botës, të cilët në numër të madh vijnë për pushime në vendlindje. Blerim Vrajolli ka ardhur në vizitë në Kosovë nga Gjermania në fund të korrikut. Ai thotë se ka bërë pagesën për sigurim kufitar. "Kam paguar 20 euro, nuk është shumë e madhe, por nuk do të duhej të ishte kjo pagesë. Kam kaluar disa shtete dhe vetëm në Kosovë e kam paguar këtë sigurim shtesë", shprehet Vrajolli.

Tarifa e sigurimit, e cila paguhet në kufi, ndryshon nga kategoria e mjeteve motorike si dhe nga periudha e qëndrimit në Kosovë. Personat që hyjnë në Kosovë me automjete me targa të huaja duhet të paguajnë 15 euro për një qëndrim prej 15 ditësh. Qëndrimi për një vit kap vlerën e 205 eurove. Këto tarifa janë më të larta për autobusë dhe për kamionë me peshë mbi një ton.

Ndryshe nga tre vjetët e mëparshëm, Qeveria e Kosovës sivjet ende nuk ka bërë ndonjë marrëveshje me Byronë Kosovare të Sigurimeve për lirin e diasporës nga kjo pagesë.

Zëdhënësi i Qeverisë së Kosovës, Përparim Kryeziu, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se janë duke punuar që të gjejnë një zgjidhje të përshtatshme për mbulimin e këtij sigurimi. "Ndonëse vullneti nga ana jonë ekziston, deri më tani nuk kemi ende një marrëveshje me Byronë e Sigurimeve", ka treguar Kryeziu.

Gjatë dy vjetëve, 2020 dhe 2021, qeveria kishte ndarë mjete nga buxheti i saj për ta mbuluar sigurimin kufitar për diasporën. Ky mbulim i sigurimit kufitar i kishte kushtuar Qeverisë së Kosovës 8 milionë euro.

Ndërkaq, më 2022, të gjithë qytetarët nga diaspora, që kanë paguar sigurimin kufitar, janë rimbursuar nga qeveria pas plotësimit të një aplikimi elektronik.

Mazreku: Të ndryshohet marrëveshja për mbulimin e sigurimit

Drejtori ekzekutiv i Byrosë Kosovare të Sigurimit, Sami

Mazreku, i ka thënë Radios Evropa e Lirë se kanë pasur kërkesë nga qeveria për një marrëveshje të re për sigurim kufitar për diasporën, por se kjo marrëveshje nuk është finalizuar. "Për ne është më lehtë të vazhdohet pa marrëveshje, të bëhet pagesa e sigurimit kufitar. Por, nëse qeveria e sheh të arsyeshme këtë marrëveshje, ne i kemi dërguar [Mistrisë së Financave, Punës dhe Transfereve] disa komente, që të ndryshohet ajo marrëveshje", ka pohuar Mazreku. Byroja Kosovare e Sigurimit është kompetente për organizimin dhe zbatimin e sistemit të sigurimit kufitar të autopërgjegjesisë. Kur drejtuesi i mjetit motorik nuk kontraktin sigurimin kufitar, nuk i lejohet hyrja me këtë mjet motorik në territorin e Kosovës pa e përmbushur këtë detyrim.

I dëmtuari, të cilit i është shkaktuar dëm nga përdorimi i një mjeti motorik me regjistrim të huaj, i pajisur me sigurim kufitar, ka të drejtën të parashtrijë kërkesë dëmshpërblimi te Byroja Kosovare e Sigurimit.

Mazreku ka thënë se, duke i parë problemet teknike, praktike dhe logjistike, në pikat kufitare që janë bërë kur ka pasur marrëveshje, është kërkuar të ndryshohet projekt marrëveshja. "Një nga kërkesat e Byrosë Kosovare të Sigurimit për këtë marrëveshje është që secili bashkatdhetar që hyn në Kosovë të regjistrohet në sistem dhe ta marrë pa pagesë sigurimin. Në këtë mënyrë do ta kemi më të lehtë t'i inkasojmë mjetet nga qeveria", është shprehur Mazreku.

Vlera vjetore e pagesave të sigurimit kufitar arrin deri në 10 milionë euro.

Lirim Krasniqi nga organizata Germin, e cila merret kryesisht me çështje të diasporës, ka thënë për Radion Evropa e Lirë se autoritetet e Kosovës duhet t'i shtojnë përpjekjet për ta futur Kosovën në Kartonin e Gjellbër. Sipas tij, këto marrëveshje janë të përkohshme dhe pa ndonjë efekt për diasporën. "Qeveria e ka paguar dy vjet [sigurimin], mirëpo kjo nuk është zgjidhje e qëndrueshme, sepse edhe e rëndon buxhetin e qeverisë. Po ashtu, në bazë të analizave që janë bërë, rimbursimet në vitin 2022 janë shumë të ulëta krahasuar me pagesat", është shprehur Krasniqi. Sipas disa vlerësimeve që ka bërë Germin, numri i qytetarëve nga diaspora që ka vizituar Kosovën gjatë muajve të verës së sivjetme është i ngjashëm me atë të vitit të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar.

Në vitin 2022 rritja e numrit të vizitorëve nga diaspora u shoqërua me një rritje të shpenzimeve të tyre në Kosovë, vlerë që arriti në rreth 1.9 miliardë euro, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës.

Po atë vit 3.6 miliardë euro u gjeneruan nga aktivitetet e diasporës në Kosovë, që përfshijnë remitencat dhe investimet.

Frika nga investimet rrit kursimet e qytetarëve në banka

PRISHTINË, 6 GUSHT - Për rreth një miliard euro është rritur vlera e depozitave të klientëve brenda një viti në 12 bankat komerciale që operojnë në Kosovë.

Vlera e kursimeve në muajin maj të këtij viti, sipas Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), ka arritur në 5.6 miliardë, derisa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka qenë rreth 4.8 miliardë euro.


Norma mesatare e interesit në depozitat e afatizuara në sektorin bankar është 1.8 për qind.

Ekspertët financiarë dhe përfaqësuesit e komunitetit të biznesit konsiderojnë se do të ishte në interes të shoqërisë që këto mjete të investoheshin në biznese e të mos mbaheshin në

banka si para të gatshme.

Mejdi Bektashi, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", njëherësh ish-anëtar i Bordit të BQK-së, thotë se vitet e fundit është vërejtur një rritje e kursimeve. Sipas tij, kursimet në Kosovë janë më të larta krahasuar me disa shtete të rajonit.

Mbi 5.6 miliardë euro ka arritur vlera e kursimeve të qytetarëve deri në muajin maj të këtij viti, në 12 bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, nga kjo shumë rreth 3.8 miliardë janë depozita të ekonomive familjare, kurse pjesa tjetër e korporatave të tjera financiare dhe jofinanciare.



Koleksioni i fermaneve turke të Kishës së Deçanit (III)



Faton B. MEHMETAJ

Një burulldi i përket ndërtimit të furrave dhe dyqaneve (shitoreve), dy në ndërtesën e konakut të kishës (të kuzhinës, trapezarisë), ndërsa dy të tjera janë dhënë si identifikim (si pasaportë) për udhëtimin e monahëve nga Deçani në metohet e veta dhe për t'u kthyer prapë në Deçan. Dy burulldi të fillimit të shek. XIX u përkasin vojvodëve deçanas. Sipas këtyre dy akteve, Valiu i Shkodrës, Mustafa Bushati përmes një akti zyrtarë të vitit 1807 e kishte caktuar vojvodë të ri të kishës së Deçanit të birin e Tafës-Mustafën me detyrën që të mbrojtë interesat e rajës dhe të vepronte sipas burulldisë. Nga dorëshkrimi serbisht i monahut, në anën e prapme të këtij dokumenti, dimë se vojvoda Tafa ishte banor i fshatit Carrabreg (Crveni breg). Në kohrat më të hershme sidomos pas pushtimit turk, vojvodët i ka caktuar valiu me dekretin e tij. Kuptohet vojvodët e manastirit të Deçanit ishin kryesisht de anas, të fisit Gash. Edhe Huxhetet janë aktgjykime të kadilerëve, vendime ose vërtetime, që janë ruajtur në riznicën deçanase afër 30 të tilla. Sipas përmbajtjes që kanë këto dokumente, mund të ndahen përafërsisht në aso huxhetesh që kanë të bëjnë me rregullimin e ngatërresave pronësore, siç është huxheti i parë i kësaj kishe ai i vitit 1565 që u është dhënë monahëve deçanas si fletë poseduese për pronat e Bivolakut që për rreth trekatërqind vjet pati fërkime gjyqësore me banorët e Isniqit. Të njëjtat procedura juridike ndërmjet kishtarëve deçanas dhe fshatarëve të Isniqit janë përsëritur edhe pas një shekulli përmes huxhetit të vitit 1663, ku isniqasit paraqiten, sipas dokumenteve turke dhe komentatorëve historianë serbë, jo vetëm plaçkitës të pronave bujqësore të kishës-vreshtave, pyllit të gështenjave dhe mullinjëve (kryesisht në Bivolar), por edhe të tillë që sulmojnë edhe ndërtesën e kishës, por pa bërë dëme materiale në të. Administrata serbe në bashkpunim me administratën turke i kordinonin veprimet për tua marrë tokat nënë shfrytëzim,

banorëve të fshatrave sidomos për rreth kishës. Banorët në shej revolte e shprehnin mllefin e tyre për uzurpimin e tokave dhe pasurisë së tyre që ja kishte rrëmbyer kisha pa të drejtë, vetëm përmes ankesave dhe shpifjeve që i bënin titullarët e kishës së Deçanit tek organet turke. Për këto ngjarje dhe hollësitë e tyre monahët deçanas ankoreshin në organet e pushtetit, duke i zmadhuar dhe shtrembëruar faktet gjithnjë në dëm të fshatarësisë së vendbanimeve përreth. Huxheti i vitit 1663 akuzon jo vetëm isniqasit, por edhe banorët e fshatrave Llukë e Vogël (Llukë e Poshtme), Prapaqan etj.

Huxhet Hatib-Zade e Mustafës, Kadi i Pejës

Bojë e zezë në letër, me vulë në fund, 14x30,5 cm


Shkruar në vitin 1663.

Signatura DK-176.

Hatib-Zade Mustafa, kadi i qytetit të Pejës, ia lëshon këtë huxhet manastirit të Deçanit me kërkesë të Genadijes e Metodijes, murgj e kujdestarë të manastirit, të cilët kanë bërë padi ndaj banorëve të fshatit Llukë e Vogëlm (Lluka e eperme), Isniq e Papraçan, arnautë (shqiptar) për nga kombësia, për shkak të zullumit të tyre, sepse nuk lejojnë të shfrytëzohen vreshtat, mullinjtë e gështenjat. Shesin gurë nga mullinjtë, shembin muret e manastirit, shkatërrojnë vreshtat etj. Është vendosur që ata menjëherë të çohen nga toka e manastirit dhe të dënohen më së ashpri. Shkruar me 5 xhemazi el-eve, të vitit 1074 (1663). Pasojnë emrat e 11 dëshmitarëve.

Vërejtje: I konservuar Nuk është publikuar.

Nuk dihet efekti i këtyre kërcënimeve të kishës së Deçanit përmes pushtetit turk, por del e qartë se banorët e kësaj ane, përmes punës bujqësore-blegtorale edhe në vitet e '50-ta e '60-ta të shek. XVII bënë rezistencë dhe nuk u pajtua me pushtuesit. Mahmut Pashë Bushati i Shkodrës, i kishte dhënë leje në vitin 1786, Danillo Kozhanegrit për ta meremetuar manastirin e Deçanit, por edhe i kishte qortuar banorët shqiptar të fshatrave për rreth, pasi që Danillo ishte ankuar tek pashai, që të mos i shqetsojnë kaluxheret dhe popat e kishës së Deçanit. Përfaqësuesit dhe personeli i kishës së Deçanit duke përfshirë këtu edhe priftërinjtë, igumenet e figurat tjera të kësaj kishe e kanë përdorur pushtetin turk dhe fuqinë e pushtetit turk përmes



Tapia në ara e livadhe në Lubozhdë, DK-283

ankesave të shumta të tyre për ti shtypur shqiptarët dhe për ti larguar nga Deçani e fshatrat për rreth, të gjithë njerëzit që ishin më ndikim në popull dhe e mbronin popullin nga padrejtësitë e pushtetit turk dhe çytjet e manastirit të Deçanit që bëheshin ndaj kësaj popullate gjithmonë në bashkpunim me pushtetin turk për ti mbajtur nënë sundim popullatën vendase. Për ta forcuar këtë mendim flet edhe Bujrudija e Abdurahmanit, mytesarifit të Dukagjinit.


Sikurse në atë kohë edhe sot personeli i manastirit të Deçanit bënë ankesa të vazhdueshme krejtësisht të pabaza dhe të improvizuara, kundër shqiptarëve autokton tek

Bashkësia Ndërkombëtare, për ta paraqitur veten të kërcnuar, vetem sa për ti mbajtur forcat e KFOR-it pranë manastirit. Probleme të ngjashme paraqitën edhe në huxhetin e vitit 1776, ku kadiu i Gjakovës vërtetonte se banorët e fshatit Deçan kanë plagosur igumanin Danillo dhe një kallogjer. Pjesa më e madhe e huxheteve kanë të bëjnë me shitblerjen e tokave, shtëpive, shitoreve dhe pasurive të tjera për manastir. Huxhetet që trajtojnë shitblerje të pasurisë janë më tepër të shek. XIX, të asaj periudhe kur kishtarët deçanas përveç përpunimit të tokës, filluan të merren edhe me shitblerjen e tokave-vreshtave, pemishte, mandej shtëpi, shitore (dyqane) etj. Më së

shumti kanë blerë vreshta dhe kanë pas mjaft leverdi dhe të ardhura të mira nga prodhimi i verës cilësore. Falja e shtëpive, tokave dhe pasurive të tjera është rregulluar me huxhetet e vitit 1798, 1801 dhe te vitit 1802. Huxhetet janë dhënë edhe për mbrojtjen e manastirit dhe kishtarëve nga maltretimet e organeve të pushtetit lokal, siç është rasti me mbrojtjen e një banori të fshatit Lloçan nga padia e padrejtë e një spahiu. (Dok. nr. 194 i vitit 1631, ku tregohet se Hasan-kadiu i rrethit të Altun-Ilisë e gjykon padinë e spahiut Hasan nga fshati Vokshiq (Voksh-i) kundër të krishterit Stana nga Lloçani dhe, në mungesë faktesh, vërtetohet pafajësia e Stanës). **Muraselja**

është dokument zyrtarë i kadiut që paraqet obligimin e pagesave të (tatimit) **xhizjeve**, në këtë rast tatimit të kishës, pasi që në një murasele të vitit 1627, urdhërohet raja t'ia paguaj tatimin kishës. Po kështu tri murasele iu kanë dhënë mitropolitit Joanikija që në periudhën e viteve 1812 deri në vitin 1815 mund të mbledhë tatimin (porezin) nëpër eparhinë e tij. Me muraselen e vitit 1779, por në bazë të fermanit të sulltanit, jepet pëlqimi për meremetimin (rindërtimin) e ndërtesës së kishës dhe konakut të saj. Me këtë hugjum-murasele myteserrifi i Sanxhakut të Dukagjinit, lejon rindërtimin e përpunimin e disa pjesëve të kishës dhe urdhëron që askush të mos i pengojë punimet aty. Nga përmbajtja e kësaj muraseleje, si dhe e dokumenteve të tjera turke për kishën e Deçanit, mund të konstatohet se urdhrat e sulltanit janë zbatuar, në të shpeshtën e rasteve, me përpikëri e besnikëri nga organet lokale të pushtetit turk e veçmas nga vezirët e pashallarët, nëpër vilajete, sanxhaqe, qarqe e nahije. Në këtë kontekst duhet marrë parasysh edhe punën e mundimshme të monahëve deçanas të cilët, në grup nga tre-katër sish, ose edhe njëri prej tyre, kanë udhëtuar këmbë gjerë në Stamboll, te patriarku grek për të intervjuar te Porta e Lartë për një dokument, për një nevojë të kishës, apo për lejimin e një mundësie të shërbimit kishtar. Në vitin 1696, i shkroi sulltani dy fermana me të cilat, vërtetonte se igumeni i Deçanit kishte statusin e sokollarëve dhe ishte i privilegjuar sipas këtij statusi. Një dokument tjetër juridik është edhe **fetfa-ja**, vendim gjyqësor (juridik) ose udhëzime juridike të dhëna në formë përgjigjeje përkitazi me çështjet e sherijetit. Pasi këto dokumente kanë pasur karakter të përhershëm, shumica nuk kanë datë as vit. Fetfa-të kanë të bëjnë kryesisht me pronësimin e pasurisë, trajtimin e pasurisë dhe të qerasë, pagimin e të dhjetave në natyrë, ndërtimin e shtëpive në tokën e vakufit, me përkujdesjen e të drejtave pronësore etj. (Dok. nr. 45 i vitit 1832, që ka të bëjë me çështjen e një toke në fshatin Carrabreg). Është me rëndësi edhe fetfa-ja e kadiut të qytetit Altun-ili (Junikut), Tejfikut, pyetja që i bëjnë kishtarët deçanas: në qoftë se një e krishterë ia fal shtëpinë ndonjë kishe për (jetim) shpirtin e vet dhe ajo dhuratë regjistrohët në sherijat (gjyq), a mund ta pengojnë atë dhuratë trashëgimtarët, të afërmit? (e të krishterës). Kësaj pyetje të gjerë Tejfik-kadiu iu ka përgjigjur shkurtimisht: "Nuk mundem". Po në vitin 1834 igumani Teofil mori lejën prej Sefedin pashës së Pejës dhe

meremetoj (rindërtoj) konakun e madh të kishës së Deçanit nga ana e veriut si dhe „odat e pritjes”. Për këto rindërtime igumani Teofil kishte përgatitur 300 kese me 150.000 grosh, që ishte shumë e madhe parash për atë kohë. Sikurse dokumentet tjera të perandorisë turke, edhe **Teskere-ja** ishte dokument i rëndësishëm që kishte rëndësinë e dokumentit personal-legjitimacion (leje udhëtimi-pasaportë); vërtetim ose ftesë (thirrje). Teskerja më e vjetër e koleksionit të riznicës së Deçanit është ajo e vitit 1569, që ka të bëjë me fermanët e shkruara për igumanin e Deçanit si sokollar i mbretit. Me këtë teskere vërtetohet se udhëheqësi i kishës së Deçanit është i përcaktuar për sokollar në çerdhen e shahinxhinjëve (sokollarëve) në Llomnicë të nahijes së Plavës, për ç'gjë ka edhe beratin mbretëror, është i liruar nga taksat e ispenxhes për bashthinën e Bivolakut. Atje mund të qarkullojë lirisht dhe askush nuk mund ta pengojë. E njëjta tematikë trajtohet edhe në teskeret e vitit 1798, që vërtetojnë obligimet dhe të drejtat e sokollarëve ("doganlluk") të igumanit deçanas Danillo Kazhanegra. Në teskeren e Muharrem-pashës së Pejës është paraqitur konflikti ndërmjet kallogjerëve deçanas dhe Gashnjanëve, banorë të Deçanit, për pronat e kishës që u takonin si "hise" banorëve deçanas. Një teskere e hershme "**Teskeja për doganxhilluk**" e vitit 1574, e cila bën fjalë për privilegjet e shahinxhinjëve (sokollarëve), ku përmenden të gjitha tatimet prej të cilave kanë qenë të lira "doganxhinjtë" e shahinxhinjtë (sokollarët) si dhe privilegjet tjera të rregulluara sipas ligjeve të Sulltan Murat-Hana II, Sulltan Mehmet-Hana II, Sulltan Bajazitit II, Sulltan Selim-Hana I, Sulltan Sulejman-Hana II dhe Sulltan Selim-Hana II, të cilët kanë mbetur në detyrat e tyre dhe kanë hyrë në librin e mbretërve. Teskerja e myteselimit të qarkut të Dukagjinit e vitit 1650, paraqet vrasjen e dy shqiptarëve të krishterë në terrenin (kufijtë) e manastirit të Deçanit dhe ky akt zyrtarë u jepet banorëve të kishës si garanci që në bazë të sherijetit (kishtarët) janë plotësisht të pafajshëm për këto dy gjaqe. Teskerja e Aliut-myteserrifit të qarkut të Dukagjinit e vitit 1776 është një akt zyrtar i pushtetit turk që mbron pronat e manastirit të Deçanit në fshatin Isniq, ku banorët vendas po ngritnin shtëpi banimi në ato prona. Sipas urdhëresës me këtë teskere, askush nuk mund të përzihet tash e tutje në këto prona të kishës. Të shek. XVIII janë edhe dy teskere që kanë të bëjnë me kishën e Deçanit. Njëra është e kadiut të Pejës, Sallabegut, e vitit 1780, e tjetra e



Diplomë e patriarkut të Stambollit Haxhi Zaharijas nga viti 1819, DK-185

Abdurrahman Pashës, myteserrifi i qarkut të Dukagjinit, e shkruar në vitin 1790. Siç del nga ky dokument myteserrifi i Abdurrahman Pasha, kishte miqësi me igumanin deçanas, prandaj e lajmëron atë se ky paska mbet në funksion edhe me fermanin e mbretit të ri të asaj kohe, ndaj jo vetëm e njofton igumanin për këtë gjendje, por edhe i bën "lutje" atij që të mos e harronte pashanë gjatë lutjeve dhe në rastin e parë të shkonte në vizitë tek ai. Teskeret tjera te Deçanit, të ruajtura deri më sot, janë ato të shek. XIX. **Këto janë 7 teskere** të pa përkthyer nga gjuha turqishte, por të gjitha këto kanë nga një dorëshkrim të igumanit deçanas në gjuhën kishtar serbe e me grafema cirilike mjaft të ndërlikuara. Këto dokumente paraqesin marrëdhënie pronësore-juridike përkitazi me pagesën e borxheve ndaj kishës, pagesën e të dhjetave, për zejen e farkëtarëve (kovaçëve) të kishës, për pagesën e vergisë e taksave të tjera. Sipas të dhënave të shkruara, asnjë teskere e shek. XIX që ka të bëjë me Deçanin, nuk është publikuar deri më sot. Dokumente të tjera për kishën e Deçanit, përveç këtyre që u përmendën këtu më sipër, janë

ruajtur edhe disa sosh, kryesisht të shek. XIX, e disa edhe të fillimit të shek. XX. Prej këtyre dokumenteve turke për Deçanin janë edhe **65 tapi, 6 procese kadastrale** të pronës, **11 dokumente** që u thonë ilam (ylam); **4 mazbata, 3 defterë, 5 lutje, 2 vërtetime, 1 shehadetname, 1 temesyq (vërtetim), 1 letër me shkrim për pronën, 1 padi e kishës për pronën (çifligun)** në Carrabreg, **44 senete, 4 izune,** dhe 3 ruhsatname. Këto dokumente, të lëshuara nga organet lokale të pushtetit, kanë të bëjnë me pronat e kishës, me leje-qarkullimin e kishtarëve deçanas nëpër këto prona, me pagesat ligjore të banorëve ndaj kishës etj. **Ruhsatname-ja**, ka qenë dokument për eprorët e kishës, leje-qarkullim, për të udhëtuar lirisht nga kisha deri në pronën e kishtarit. E tillë është ruhsatnameja e igumanit të Deçanit, ku thuhet se "askush nuk mund ta pengojë gjatë rrugës igumanin deçanas dhe askush të mos e sulmojë atë në vreshtat e manastirit të Deçanit në Hoçë të Madhe". **Izunet**, janë dokumente të karakterit juridik, leje e lëshime të kadiut për punët në ndërtimtari, për rindërtim (meremet) dhe ndërtim të

ndonjë objekti të kishës. Përveç fermanëve dhe muraseleve, për rindërtimin e ripërpunimin e ndonjë objekti të kishës nevojitej edhe izuni që e lëshonin myteserrifi (kryeshefi i qarkut) dhe zëvendësi i mytevelisë (drejtori i vakufit) në bazë të burulldisë që e lëshonte valiu i Rumelisë (gubernatori i krahinës). Përveç këtyre dokumenteve, për ndërtimin e ndonjë pjese të konakut të kishës së Deçanit, kërkohej nga organet e pushtetit, sipas rrethanave, edhe muraselja e lëshuar nga gjyqi. Një dokument i tillë është izuni i vitit 1804 për ripërpunimin e disa pjesëve të mureve anësore të kishës. Disa dokumente izun-e dalin edhe me format **izunteskere**, siç është ajo e Sejfi Pashës dhe e Osman Begut. **Senet-i** është dokument turk me kuptimin e një dëftese, dëshmie, vërtetimi, për pagesën e të dhjetave, pagesën e tatimit të pasurive që kisha u paguante spahinjëve etj. I kemi gjetur **44 senete** të kësaj kishe, por numri i këtyre dokumenteve arrin në më shumë se **50 sosh**. Senetet jane dokumente kryesisht të shek. XIX e deri në fillim të shek. XX, por një numër i vogël i tyre janë përdorur që nga fundi i shek. XVIII. Disa senete që kanë

formën e lutjeve paraqesin rastin e fillimit të punës për rindërtimin e ndonjë pjese të ndërtesave të kishës. Një senet i tillë është lutja e Ali Zylfikarit drejtuar Ket-hud Beut të Pejës që t'ia jepte lejen për të filluar punën në rindërtimin (meremetin) e kishës së Deçanit, për ç'gjë kisha i kishte paguar taksat e nevojshme. Për këtë punë Ali Zylfikar kishte marrë përgjegjësinë si dhe një shumë parash prej 1000 akçesh. Një senet tjetër është dëshmi se kallogjerët deçanas kanë marrë 1000 akçe nga të ardhurat e kishës për tokën dhe vreshtat në fshatin Deçan nga serbët e Deçanit. Nga koleksioni i këtyre dokumenteve hasen të dhëna se kishtarët deçanas, jo vetëm në Pejë, por edhe në Gjakovë kanë paguar tatim-haraç. (Dok. nr. 260/1 i vitit 1876-1877. Në anën e prapme të këtij dokumenti përgjegjësi kishtar vërteton, përmes dorëshkrimit të tij serbisht, se me datën 1 tetor 1876 ka paguar 2.030 grosh tatim-haraç. Këto para i çoi Rusta në Gjakovë. Më 20 janar 1877 vit i përcollëm për Rustën 577 grosh, shkruan në këtë dokument.) **Tapi-a** (shm. *tapitë*) janë dokumente juridike turke që kanë të bëjnë me posedimin e tokave (pasurisë së patundshme) të shtëpive dhe pasurive të tjera të kishës së Deçanit. Në manastirin e Deçanit gjënden diku rreth 65 sosh.

HUXHET I MEHMEDIT, KADI NGA ALTUN-ILIA

*Bojë e zezë në letër, me vulë në fund të faqes, 13,5x30 cm
Shkruar në vitin 1649*

Signatura DK-192

Mehmedi, kadi nga Altun Ilia, në bazë të urdhrat të mbretit lëshon këtë akt që organet policore nuk mund ta shqetësojnë manastirin e Deçanit me justifikim se në rrethinën e manastirit është vlarë një njeri, deri sa për këtë të mos lëshohet vendimi i kadiut. Shkruar në muajin muharrem të vitit 1059 (1649), pasojnë nënshkrimet e gjasthë dëshmitarëve.

Në faqen e parë, mbi fillim, shënimi: [serbishte e vjetër]

Në faqen e pasme: [serbishte e vjetër]

Vërejtje: i konservuar.


Nuk është publikuar.

Si dëshmi për posedimin (përkatësinë pronësore) të pronës, tapia ka gjithnjë vlerë edhe në kohën tonë. Dy tapi të vjetra të kishës janë ato të vitit 1565, që vërtetojnë të drejtën e kishës së Deçanit për pronat e saj-pyjet, vreshtat, arat dhe mullinjët që ka pasur në fshatin Deçan. Dokumentet të tjera të këtij grupi janë të periudhës së fillimit të shek. XVIII e deri te fillimi i shek. XX dhe janë këto tapi të lëshuara me rastin e shitblerjes së pasurisë së kishës.

Ndër dokumentet tjera të kishës së Deçanit gjenden edhe një numër i madh **defteresh** (tefteresh) e **mazbatash**, ku janë paraqitur të dhëna për "gjymrykun" për verë (vënë); obligimi i çifçiu për pagimin e **qesimit**, mandej mazbata për posedimin e pronave etj. Dokumentet që u thonë **teftere** (deftere) ashtu si tapitë dhe mazbatat, janë akte juridike të lëshuara për regjistrimin e pronave-tokave të kishës së Deçanit. Vetëm për pronat e kishës në Bivolak, pos dokumenteve të tjera që nga shekulli XIV e këndeje, gjenden edhe dy deftere, prej të cilëve mund të nxirren të dhëna relevante për mënyrën e jetës së banorëve të këtyre anëve që nga shek. XIV e deri në vitin 1912. Sipas këtyre tri dokumenteve tapive, mazbatave dhe deftereve, që vetëm sa u cekën në këtë shkrim, mund të pohohet se kisha e Deçanit ka pasur pasuri të patundshme - toka (vreshta, ara, livadhe, pyje) si dhe shtëpi-ndërtesa, objekte etj., jo vetëm në terrenet e Deçanit me rrethinë, por edhe në vende tjera, si bie fjala, në Lybeniq, në Hoçë të Madhe të Prizrenit, në Osojan, në fshatin Sinaj, në Pejë, në Sofi (Bullgari), në Dobërdol (Pejë) si dhe Tetovë (Maqedoni), Plavë, Shekullar e vende të tjera që janë cekë më lart në këtë punim.

Në mes dokumenteve të tjera të rëndësishme për kishën e Deçanit janë edhe **ilamet** (ilam) aktgjykime dhe vendime të gjyqit. Janë rreth 10 **ilame** të kishës, ndër të cilët më i vjetri është ai i vitit 1579. Përmes këtij ilami organet e larta të pushtetit lokal në Gjakovë, sipas kërkesës së igumanit deçanas, vërtetojnë se në manastirin e Deçanit nuk ka kryengritës, por, në qoftë se ata paraqiten, do të arrestohen dhe do t'i dërgohen pushtetit nëpërmes të drejtorisë së manastirit. Ilamet tjera paraqesin pengesat e ndryshme që ka pasur kisha e Deçanit për posedimin e pronave të saj. Janë 3-4 ilame ku paraqiten ankesat e kishtarëve deçanas ndaj banorëve të fshatit Isniq për shkak të pronave të dikurshme të kishës në Bivolak. Të gjitha këto procese gjyqësore, siç shihet nga dokumentet në shqyrtim, kanë ruajtur interesat e kishës e jo të fshatarëve isniqas që e kishin pronë të vetën Bivolakun që nga Mesjeta e Hershme.

Është me rëndësi njëfarë dokumenti-kontrate ndërmjet manastirit të Deçanit dhe pushtetit ushtarak turk, që në kohërat e vështira, në prag të luftërave ballkanike më 1909, e ruajtën manastirin deçanas. Kjo kontratë është e shkruar në gjuhën turqishte dhe serbishte me një letër përcjellëse në gjuhën rusishte. (Dok. nr. 124 i vitit 1909, kontratë e



Vula e manastirit Gorioç në Belle te Deçanit

jeremonahut Kirill me oficerët turq, që rrinin në kishën e Deçanit gjatë vitit 1909.) Ky dokument-kontratë është shkruar në 10 fletë të formatit 22 x 27 cm. Vlenë të theksohet se dokumentet turke, fermanet, bujurullditë etj., të shek. XVI, XVII, XVIII, i ka përkthyer (shumicën prej tyre) konsulli rus në Prizren Ivan S. Jastrebov (studiuues i kishës së Deçanit). Shumica prej këtyre dokumenteve, sidomos ato që për kishë ishin të rëndësishëm, e kanë në fund të tyre osë në anën e kundërt një referencë, një sqarim rreth përmbajtjes së dokumentit të shkruar edhe nga monaku ose igumani në gjuhën serbishte. Jastrebovi, përveç dokumenteve të tjera, shfrytëzoi shumë fermanet turke sepse ishte orjentalist i shkëlqyer dhe dokumentacionet tjera të Deçanit (kishës së Deçanit), i ka përkthyer nga turqishtja në serbisht. Në pjesën e dytë të librit të Jastrebovit, është botuar përmbajtja e fermaneve që mund të shërbejnë si të dhëna për biografinë e mitropolitit prizrenas Joanikija. Kurse në kapitullin e tretë të veprës së Jastrebovit përmban "Gjendjen e manastirit të Deçanit në tre shekujt e ardhshëm, sipas burimeve turke që gjenden në manastirin e Deçanit". Hulumtimet dhe të dhënat e J. S. Jastrebovit u botuan rusisht në një libër të vëllimshëm si vepër e postume në vitin 1904 me titull: "J. S. Jastrebov, Stara Srbija i Albania, spomenik SKA, XLI, Beograd, 1904", e më vonë edhe vepra tjetër: "J. S. Jastrebov, Manastir De ani, Bratstvo XII-XIII, Beograd 1908", ku përshkruhet tempulli i Deçanit (kisha) dhe me këtë rast, jep të dhëna për gjësendet (mjetet, orenditë...) që gjendeshin në Riznicën e kësaj kisha sidomos për ato mjete që i ka konsideruar si të rëndësishme.

FERMAN I SULLTAN SELIMIT II Bojë e zezë në letër, me turgë në krye, 21x52,7 cm

Shkruar në Stamboll, në vitin 1572.

Signatura: DK-199

Dërguar kadiut të Pejës, Memih, spahi i manastirit të Deçanit, Bellesë, Istogut, Shën Nikollës (Gorioçit) dhe manastireve tjera në kadiullkun e Pejës, kërko nga manastiret e përmendura të dhjetat, ndonëse me defterin mbretëror u është caktuar tatimi me seksion prej 1000 akçesh. Duhet të hetohet rasti dhe të mos merret as një akçe më shumë se që është caktuar. Shkruar në Stamboll, 7 zilkade 979 (22 II 1572).*


Në faqen e pasme: serbishte e vjetër,

Vërejtje: I konservuar.

Në kuadër të projekt të Millosh S. Millojeviq dhe konsullit rus Jastrebovi, për rikonstruktimin e historisë serbe e shkroj një vepër edhe arkimandriti i Kishës së Deçanit Leontije Ninkoviq me titull "Srpska lovrà Visoki De ani" (Llovra Serbe e Deçanit të Lartë)", botuar në Pejë në vitin 1923. Edhe ky është përpjekur që t'i shpjegojë disa fermane të Sulltanit, prej të cilave ka nxjerrë përfundime (konkluzione) për pozitën e Deçanit gjatë historisë. Në vitin 1920 Mehmet-beg Sylejman pashiq nga Travniku, duke kërkuar (gjurmuar) udhëheqësin e kishës Leontije Niakoviq-in, i përktheu në gjuhën boshnjake të gjitha dokumentet turke që gjendeshin në kishën e De anit, por se nuk janë botuar si të tilla. Kurse një pjesë të fermaneve turke që gjendeshin në Manastirin e Deçanit (jo të gjithë) i kishte përkthyer në vitin 1963 nga osmanishtja në shqip, studiuuesi i njohur shqiptar dr. Hasan Kaleshi. Për disa shkaqe, dr. H. Kaleshi i perktheu vetëm 14 fermane nga koleksioni i doku-

menteve në fjalë, që u publikuan në Vjetar (Glasnik) të Muzeut të Kosovës (X-1970) në Prishtinë. Për studiuuesit shqiptar ky fond kaq i madh i dokumentacioneve që janë ruajtur në arhivat e manastirit të Deçanit nuk është hapur kurrë. Por, njëri ndër dokumentet e rëndësishme të administratës turke ku përmendet kisha e Deçanit është Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485, i përkthyer në gjuhën shqipe nga **Selami Pulaha**. (Selami Pulaha, **Defteri i regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485**, I, Tiranë 1974). **Këso kohe terreni i kishës së Deçanit ishte pjesë e administrimit të Sanxhakut të Shkodrës, përkatësisht e kazasë së Pejës.** (Në vitin 1485 Sanxhaku i Shkodrës ndahej në katër kaza: të Shkodrës, të Podgoricës, të Pejës dhe të Bihorit. Kazatë ndaheshin në nahije. Kazaja e Pejës ndahej në nahijen e Pejës, të Atllun-Ilisë (Junikut me rrethinë) dhe të Suhogërlës. Megjithkëtë, terreni i Deçanit me rrethinë, ku bën pjesë edhe kisha e Deçanit, përfshinte një grup të madh fshatrash të veçantë dhe ishte i regjistruar edhe si ziamet, ashtu si dhe ziameti i Suhogërlës etj. Feudi paraturk i Deçanit kapte një sipërfaqe të madhe (2500 km²), por edhe në vitin 1485 përfshinte një unitet të veçantë krahinor - një ziamet, që ruajti trashëgimi nga e kaluara e largët.). Nga ky defter shihet se manastiri i Deçanit asokohe kishte 12 kallogjerë (kallogjer) dhe 12 shtëpi, 7 mullinj si dhe një sipërfaqe të konsiderueshme të pronave - ara, livadhe, vreshta, pyje gështenjash, ku prodhoheshin bereqetet: gruri, thekra, elbi e veçanërisht rrushi, kumbullat, gështenjat dhe arrat. Përmenden në këtë dokument edhe bletët, prodhimi i linit e melit si dhe taksa që paguante kisha për këto bereqet që kapte

shumën prej 12.624 ispenxhesh. Koleksioni i dokumenteve në gjuhën turqishte për kishën e Deçanit është një ndër lëndët më të rëndësishme dhe më të njohura që është ruajtur në arkivin e kësaj kisha. Këto dokumente në gjuhën turqishte si dhe të dhënat që gjenden në to, paraqesin lëndën më të saktë të këtij punimi për periudhën nga shek. XVI-XIX të historisë së kësaj kisha. Por, një gjurmim më i përimtuar dhe gjithëpërfshirës i përmbajtjes së këtyre dokumenteve do të ofronte njohje të reja për historinë e kishës së Deçanit dhe të popullatës së Rrafshit të Dukagjinit në periudhën e qeverisjes turke në këto krahina. Sikurse fermanet të një rëndësie të veçant janë edhe vulat. Në manastirin e Deçanit janë gjetur 25 vula. Këto vula janë të




Dërguar kadiut të Pejës. Ka të bëjë me shfrytëzimin e tokës në të cilën manastiri i Shën Nikollës ka tapi, (v.j. Manastiri i Shën Nikollës gjendet në Belle) e të cilën e ka marrë një spahi. Kadiu duhet ta hetojë rastin, dhe në qoftë se manastiri qeveris me këtë tokë në bazë të tapisë së rregullt, le të ndalohet spahi në pengimin e manastirit në të drejtën e pronësisë. Nëse nuk dëgjon, të njoftohet sultani. Fermani le të mbetet në duar të manastirit. Shkruar në dekadën e fundit të muharemit të vitit 985, në Stamboll (10-20 IV 1577)

E ashtuquajtura “kishë serbe” e Deçanit, ishte privilegjuar dhe mbrojtur nga sultanët dhe pashallarët turq për kontributin luftarak që treguan gjatë kohës së aleancës ushtarake të tyre (e cila filloi qysh nga Lufta e Kosovës e vitit 1389). Ky bashkëpunim përfundoi në vitin 1766, kur Sultan Mustafa i III-të lëshoi Beratin për shuarjen e autonomies kishtarë serbe, duke u vu prapë nën qendërën kishtarë të Konstatinopojës. Kështu kishat ortodokse të Kosovës u kthyen prapë në gjirin e ortodokësve shqiptarë.

Fusnotat

Dokumenti DK-6 në “De anka Riznica” të autores M. Shakota, f.390, ku shihet se dokumentin e shkroi sultan Abdullah Hamiti I, në Stamboll në vitin 1776, sipas lutjes që ia kishin drejtuar sultanit patriarku i Stambollit dhe Sinodi i Shenjtë. Shih për manastirin Kallafat pak më gjerësisht: M. Ivojinovi, *Svetogorske kelije i pargovi u srednjem veku*, Beograd, 1972, f. 22, 26, 55, 56.
 Dok. nr. 197 i vitit 1779, burulldia e Tahir Muharrem Pashës, dërguar kadiut të rrethit të Altun - Ilisë, përkritazi me ankesën e kallugjerëve të De anit, të cilët ankohen se disa keqbërës i frikësojnë kallugjerët dhe nuk i lënë të dalin të lire nga ndërtesa e kishës dhe dëshirojnë t'i pla kitin kallugjerët. Urdhërohet kadiu që përmes organeve shtetërore t'i shkatërojnë këta kriminelë e kishtarët tani e tutje të jenë të qetë.
 Dok. nr. 24 i vitit 1786, burulldia e Mahmut Pashës së Shkodrës e shkruar më 19 muharrem 1201 (1786 vit) sipas ankesës së igumanit Danillo. Pasha i Shkodrës jep urdhër që askush të mos e

trazonte igumanin Danillo.
 Dok. nr. 305 i vitit 1801, burulldia e Abdurrahmanit – myteserrif i Dukagjinit jep këtë akt zyrtar për ta mbrojtur kishën e De anit nga pagesat e gjaqeve që u bënë në fshatin Bivolak dhe i drejtohet myteselimit të Pejës që banorët e Isniqit t'ia pagujnë kishës së De anit detyrimet që kanë ndaj saj.
 Për sokollarët ka shkruar më parë J. S. Jastrebov, *Iz putni kog zapisnika*, f. 50-55; Po ai në *Stara Srbija i Albanija*, Spomenik SKA XLI, Beograd 1904, f. 30-32; Po ai në *Manastir De ani*, Bratstvo, XII-XIII, Beograd 1908, f. 183-189; Gliša Elezovi, *Sokolarstvo i sokolari*, Ju na Srbija IV, Skoplje 1923-1924, f. 31-40.
 Letonije Pavlovi, *Zbirka pe ata iz de anke riznice*, Neki spomenici kulture II, Smederevo 1963, 63-85.
 Dok. nr. 197 i vitit 1779, burulldia e Tahir Muharrem Pashës, dërguar kadiut të rrethit të Altun-Ilisë, përkritazi me ankesën e kallugjerëve të Deçanit, të cilët ankohen se disa keqbërës i frikësojnë kallugjerët dhe nuk i lënë të dalin të lirë nga ndërtesa e kishës dhe dëshirojnë t'i plaçkitin kallugjerët. Urdhërohet kadiu që përmes organeve shtetërore t'i shkatërojnë këta kriminelë e kishtarët tani e tutje të jenë të qetë.
 Dok. nr. 305 i vitit 1786, burulldia e Mahmut Pashës së Shkodrës e shkruar më 19 muharrem 1021 (1786 vit) sipas ankesës së igumanit Danillo. Pasha i Shkodrës jep urdhër që askush të mos e trazonte igumanin Danillo.
 Dok. nr. 300, pa datë lëshimi, formati 30 x 45,7 cm, dokument në gjuhën serbishte e turqishte: Regjistrimi i pasurisë së manastirit të Deçanit në Lybeniq; Dok. nr. 271 i vitit 1893 – tapi e kishës për një shtëpi në Lybeniq, etj.
 Dok. nr. 39, tapi e vitit 1833 për arat e vreshtat e kishës së Deçanit në Hoçë të Madhe, etj.
 Dok. nr. 296 i vitit 1816, tapi e kishës së Deçanit për pasurinë (arën) në Osojan.
 Dok. nr. 111, tapi e kishës së Deçanit e vitit 1848 për pronën (çifligun) e saj në fshatin Sinajë (Sinëjë).
 Dok. nr. 38 i vitit 1852, tapi e kishës për një shtëpi në Pejë.
 Dok. nr. 81 i vitit 1852, tapi e kishës së Deçanit për një shtëpi në Sofi (Bullgari).
 Dok. nr. 43, i vitit 1823, tapi e kishës për një livadh në fshatin Dobërdol (Pejë).
 Dok. nr. 318 i vitit 1579, ilam që në manastirin e Deçanit nuk ka kryengritës. Këtë dokument e nënshkroi pos të tjerëve edhe Ismaili, kadiu i Altun-Ilisë.
 Dok. nr. 328, ilam i vitit 1767, përmes të cilit u tërhoqet vërejtja banorëve të Isniqit që të mos i pengonin kallugjerët deçanas në pronat e tyre në Bivolak; Dok. nr. 298, ilam i vitit 1815 ku kadiu i Pejës, Numani, gjykon rastin e ngatërresave të banorëve të Isniqit me




kallugjerët e kishës për shkak se isniqasit pengonin kishën për ta shfrytëzuar tokën e Gushavcit. Gjykata vendosi në të mirë të manastirit; Dok. nr. 304 i vitit 1866, ilam i vërtetuar me tetë vulosje turke e dy vulosje serbe, i përkthyer edhe në gjuhën greqishte. Dokumenti paraqet lëndën gjyqësore për tokën e kishës në Isniq, ku isniqasit duhej t'i paguanin kishës të katërtën e prodhimit.
 Dok. nr. 305 i vitit 1801, burulldia e Abdurrahmanit - myteserrif i Dukagjinit jep këtë akt zyrtar për ta mbrojtur kishën e Deçanit nga pagesat e gjaqeve që u bënë në fshatin Bivolak dhe i drejtohet myteselimit të Pejës që banorët e Isniqit t'ia pagujnë kishës së Deçanit detyrimet që kanë ndaj saj.
 Mirjana Šakota, *De anka riznica, ; M. Krasniqi, vep. e cit. f. 110, Përktheu dokumentin nga turqishtja H. Kaleshi-Eren, në Glasnik Muzeja Kosova, Prishtinë, 1970, f. 308-309; J. S. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Relacione për gjendjen e Shqipërisë të mesme në shekullin XVII, Vëllimi I (1610-1634), Tiranë, 1963, f. 337. Jastrebov, Iz putni kog zapisnika, 43-44, duke i vënë datën e gabueshme më 1537 (por H. Kaleshi e rregulloi datën e këtij fermani më 1539).
 M. Shakota, vep. E cit. f.59; shih edhe dokumentin në gjuhën turqishte, formeti 14x30,5 cm. Signature DK-176.
 M. S. Millojevi, Putopis III, 23; J. S. Jastrebov, Manastir De ani, 196-197. Dokumenti – 310; 343; 36; V. Petkoviq-Dj. Boshkovi, De ani I, 14; Mirjana Šakota, De anka Riznica,
 “Punë e keqe e cila nuk i përket” në “De anka Riznica” të autores M. Shakota, f. 63.
 Dok. nr. 57 i vitit 1565, dy fletë tapi të ngjitura bashkë, e para 15,5 x 24,5; e dyta 30,8 x 20 cm. Me këtë dokument i tërhoqet vërejtja timarliut të Deçanit Mehmetit, të birit të Jusufit, që të mos ia merrte kishës pronat e saj për të cilat i kishte tapitë.
 Dok. nr. 51, pa datë lëshimi, i formatit 38,5 x 55,5 cm; i shkruar me ngjyrë të zezë në letër; i vërtetuar me 8 vulosje dhe 41 kryqa analfabetësh (nepismenih); mazbatë për ta marrë “qesimin” e tokave-pronave të kishës nga çifçinjët në Prizren. Këtë mazbatë e lëshoi gjykata e Prizrenit.
 Përktheu dokumentin nga turqishtja H. Kaleshi-Eren, në Glasnik Muzeja Kosova, Prishtinë, 1970, f. 308-309; J. S. Jastrebov, Iz putni kog zapisnika, 43-44, duke i vënë datën e gabueshme më 1537 (por H. Kaleshi e rregulloi datën e këtij fermani më 1539).
 Dok. nr. 291, i vitit 1804, i nënshkruar nga Mehmet Saiti në Stamboll.*

Dok. nr. 321, i vitit 1847 është fermani i Sulltan Abdullah Mexhidit drejtuar kadiut të Pejës dhe myftiut, sipas kërkesës së kishtarëve deçanas se një banor nga Isniqi po pengon posedimin e katër vreshtave në Bivolak për çka manastiri e ka tapinë. Në anën e prapme të këtij dokumenti gjendet dorëshkrimi serbisht H. Kaleši - M. Eren, **etmaest turskih fermana manastira De ana**, Glasnik Muzeja Kosova X, Prishtina, 1970.
 Berat i Sulltan Mustafës IV nr. 13 i vitit 1808, i shkruar në Stamboll (turqisht më 4 safer 1223), ku thuhet pos të tjerash: “Me kërkesën e mitropolitë së Stambollit bashkohen mitropolitë e Prizrenit dhe Novi Pazarit në një mitropoli dhe Joanikija urdhërohet mitropolit i Prizrenit, Novo Brdos, Prishtinës, Pejës, Vuçitërnës, Gjakovës, Novi Pazarit, Trgovishtës (Rozhajës) dhe Mitrovicës...”
 Qazim Lleshi, **Deçani**, vështrim antropogjeografik, “Përparimi”, nr.1-2, Prishtinë 1961, f.78
 Dok. nr. 351 i vitit 1792, ka 12 fletë të formatit 46 x 28 cm. Të palidhura.
 Dok. nr. 352 i vitit 1830-1871, ka 62 fletë të formatit 24 x 99 cm.
 Dok. nr. 353 i datës 1831-1860, ka 53 fletë të formatit 22,2 x 16 cm.
 Dok. nr. 227 i vitit 1835, ka pesë fletë të formatit 50 x 18,5 cm; edhe regjistri tjetër i çifçinjëve të manastirit të Deçanit, nr. 228 i vitit 1835, që ka formën e fletushkës me 20 fletë të lidhura, dimensiononi 42 x 17 cm ku janë dhënë emrat e çifçinjëve, sasia e tokës që e punojnë si dhe obligimet që kanë pasur ndaj manastirit.
 Dok. nr. 357 i vitit 1870, teftër serbisht për tokën e kishës në Isniq.
 Dok. nr. 359, pa vitin e shkrimit, ka 12 fletë të formatit 45 x 27,5 cm.
 Dok. nr. 355 i vitit 1855-1880, ka 178 fletë të formatit 24 x 37,5 cm., lidhur me kopertina të forta kartoni.
 Dok. nr. 354 i viteve 1855-1862, ka 67 fletë të formatit 31 x 21 cm, lidhur me kopertina kartoni të mbështjella me lëkurë; Dok. nr. 356 i viteve 1868-1869; Dok. nr. 358, pa vit botimi, formati 40 x 18 cm.
 Dok. nr. 350, fillimi i shek. XIX, formati 60 x 88 cm.
 Dok. nr. 365 i vitit 1843, shkruar nga Lazar Petroviqi - mësuesi i Prizrenit, formati 55 x 80 cm.
 Dok. nr. 21, fillimi i shek. XIX, formati 55 x 80, e shkroi Lazar Petroviqi; Dok. nr. 186, fillimi i shek. XIX, formati 46 x 56 cm.
 Dok. nr. 360, gjysma e dytë e shek. XVI, formati 126 x 63 cm.
 Dok. nr. 361, gjysma e dytë e shek. XVI, formati 128 x 31 cm.
 Dok. nr. 362, gjysma e dytë e shek. XVI.

FERMAN I SULLTAN MURATTI III
Bojë e zezë në letër, me turgë në krye, 21x48 cm
Shkruar në Stamboll, në vitin 1577.
Signatura: DK-207

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Fazliu: Synimi i madh për mua mbetet medalja olimpike

PRISHTINË, 6 GUSHT - Xhudistja Laura Fazliu, ka fituar medaljen e artë në Mastersin e Budapestit, garë kjo më e madhja pas Lojërave Olimpikë dhe Kampionatit Botëror. Në një prononcim për European Judo Union, ajo është shprehur

e kënaqur me fitoren, por ka thënë se synimi i saj i madh mbetet medalja olimpike. “Që mund të qëndroj sërish në podium si në Jerusalem, e prisja këtë. Por të marr medaljen, të festoj fitoren time të parë në turneun botëror, kjo

është befasuese edhe për mua. U ndjeva shumë mirë që nga lufta e parë sot, nuk isha nervoz. Mendoj se e meritova fitoren sot. Mësova nga gabimet e mia në Jerusalem. Kur e dija se do të luftonim sërish me njëra-tjetrën në

finale, mendova se mund t'i befasoja. Unë arrita ta bëj këtë”, ka thënë Laura Fazliu. “Fitimi i Masters është një hap i madh për mua. Por synimi i madh për mua mbetet një medalje olimpikë!”, ka shtuar Fazliu.




Krasniqi pas triumfit në Prishtinë: Faleminderit të gjithëve

“Epoka e re”

PRISHTINË, 6 GUSHT - Robin Krasniqi e ka fituar ndeshjen e 60-vjetorit duke diskualifikuar kundërshtarin në raundin 9. Kryeqyteti i Kosovës, Prishtina po shijonte mot të mrekullueshëm veror disa ditë dhe javë më parë, përveç në natën e luftës së pestë. Në gusht, retë u rrotulluan mbi qytet dhe pak para se të fillonte ngjarja, shiu i rrëmbyeshëm dhe bubullima filluan pothuajse të anulonin natën e ndeshjes dhe mijëra tifozë nuk ishin në gjendje të hynin në stadium për shkak të motit. Policia dhe forcat e sigurisë pastruan stadiumin me një orë vonesë pasi shumë njerëz ishin rrugës për në shtëpi përsëri, por organizatorët nuk u dorëzuan dhe e shfrytëzuan

maksimumin. Tifozët që tashmë kishin marshuar brenda, kështu shkuan në zonën e mbuluar dhe për shkak se jo të gjithë mund të përshtateshin atje, forcat e sigurisë nuk lanë më tifozë të hynin brenda. Luftimet u zhvilluan të gjitha, përkundër të gjitha vështirësive të motit dhe në fund Robin Krasniqi u kurorëzua me 53. Fitore në betejën e 60-të Profesioneiste. Kundërshtari doli në Runde të 9-të i skualifikuar sepse ishte penalizuar disa herë për rrahje të paligjshme me ulje pikësh, por nuk mësoi asgjë prej saj. Robin zbriti goditjet e qarta si dhe disa goditje me ndikim në luftë dhe kështu ishte tashmë në ballë të tabelave të rezultateve, megjithatë ishte shumë keq që kundërshtari boksoi kaq i papastër. “Ajo ishte një natë kaq e

çmendur që nuk do ta harroj kurrë. Më vjen shumë keq që kaq shumë tifozë nuk mundën ta shihnin luftën drejtpërdrejt në vend dhe sidomos nuk mund të ishin afër ringut, por jam i lumtur që funksionoi, pavarësisht se kushtet ishin të jashtëzakonshme. Prisja që kundërshtari të boksonte pisët, por ta ekzagjeronte në atë masë që është shumë josportive. Dua të falënderoj nga zemra të gjithë tifozët dhe mbështetësit që erdhën jo vetëm nga Kosova dhe Shqipëria, por nga Gjermania dhe gjithë Evropa. Faleminderit trajnerëve të mi dhe më e rëndësishmja falënderoj ekipin tim që kanë punuar pa u lodhur për javë të tëra për ta rikthyer këtë gjë në këmbë. Faleminderit, faleminderit”, ka thënë Krasniqi.



Përmbillet me sukses seminari katërditor për gjyqtarët

PRISHTINË, 6 GUSHT - Ka përfunduar me sukses seminari katërditor për gjyqtarët, i cili u organizua nga Komisioni i Gjyqtarëve i Federatës së Futbollit të Kosovës, në hotelin “Star Hill”, nën përkujdesjen e instruktorit të FIFA-s, Alan Snoddy dhe trajnerit të fitnesit, Simon Breivik. Në përmbilje të këtij seminari, i cili u vlerësua shumë i rëndësishëm dhe i suksesshëm nga ligjëruesit dhe Komisioni i Gjyqtarëve, ishte i pranishëm edhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi. Ai me këtë rast falënderoi instruktorin e FIFA-s, Alan Snoddy dhe bashkëpunëtorin e tij për përkujdesjen dhe përkushtimin e tyre ndaj gjyqtarëve të futbollit kosovar. Kreu i FFK-së vuri në pah



rëndësinë dhe suksesin që kanë treguar seminarin e tilla në vitet e fundit, duke kontribuar në rritjen e

nivelit të gjyqtarëve. Kjo, sipas tij, ka çuar në delegimin e tyre të vazhdueshëm në ndeshjet e

garave evropiane nga UEFA. Presidenti Ademi përgëzoi gjyqtarët për suksesin e arritur në

këtë seminar dhe uroi që ata të kenë një edicion të suksesshëm në ndarjen e drejtësisë. Edhe instruktori i FIFA-s, Alan Snoddy u nda i kënaqur me atë çfarë treguan gjyqtarët gjatë punimeve të këtij seminari dhe u zotua se edhe në të ardhmen do ta japë kontributin e tij në ngritjen e kuadrove të reja të këtij segmenti të rëndësishëm në Kosovë. Ndërkaq, kryetari i Komisionit të Gjyqtarëve, Përparim Hasani, shprehu kënaqësi për ecurinë e këtij seminari dhe për shkathtësitë që kanë treguar gjyqtarët gjatë katër ditëve të punës intensive, me besim se edhe në edicionin e ri ata do të dëshmojnë profesionalizmin e tyre në ndeshjet kampionale.


Ballkani konfirmon largimin e Albion Rrahmanit

SUHAREKË, 6 GUSHT - Kampionia në fuqi e Kosovës në futboll, Ballkani ka konfirmuar se sulmuesi i tyre, Albion Rrahmani është larguar nga klubi

suharekas. Kampioni i Kosovës është pajtuar për shitjen e tij, ndonëse ata nuk e zbuluan klubin e ri të Rrahmanit. “Çdo gol që ke shënuar, do të mbetet në

zemrat e secilit tifoz të FC Ballkanit, në zemrat e secilit prej nesh. Çdo minut që ke djersitur me vetëmohim fanellën e klubit, do të ruhet në

kujtesën e pashlyeshme, sepse kontributi yt ishte vlerë e madhe për rrugëtimin tonë të përbashkët”, ka njoftuar skuadra e Ballkanit.





ROYAL CROWN



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

